



**R E P U B L I K A E K O S O V Ë S**

**/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/**

**GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË /OPŠTINSKI SUD U MITROVICI/ MUNICIPAL COURT IN MITROVICA**

**C.nr.66/2009**

**GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesve; dhe nga Mitrovica, Rr. p.n., te cilet i perfaqson Avokat; nga Mitrovica sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditureve; dhe nga Mitrovica , tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqson perfaqsesi i perkohshem, Avokat ; nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaje gjykate , baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e kontestit; 1.250,00 Euro, pasc mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.22.05.2012, jep kete;

**A K T G J Y K I M**

**I- APROVOHET** kerkespadia e paditesve dhe nga Mitrovica dhe **VERTETOHET** se paditesit jane shfrytzues te perhershem te palujtshmeris me nga 1/3, pjeses se parc.kat.2799 me kultur Pemishte e klases 2, ne vendin e qujtur " Vreshtat" me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, ne sipërfaqe **S=1149m2**, dhe pjeses se parc kat. **2798/1** me kultur Vresht e klases se 2, ne vendin e qujtur " Vreshtat" me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes ne sipërfaqe **S=161 m2**, sipas qertifikates se pronis nr.1274, ZK Mitrovica e qe evidentohet ne emer te paditureve;

**II- DETYROHEN** te paditurit qe te iu njohin kete te drejte paditesve dhe ti lejojne qe paditesit kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te tyre prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovica, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

-Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditesit ne padin e tyre te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se te njejtit ne vitin 1984 kane blere pjesen e palujtshmerise se tyre te cekur ne dispozitiv me qmim te shitblerjes prej 14.000 DM dhe menjeher kan ber pagesen e qmimit te shitblerjes dhe kane hyre ne posedim te pasurise se blere.

Pasi qe te paditurit jane ne adrese te panjohur i propozojne gjykates qe te iu caktoi perfaqsesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesve ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise te paditesve ti aprovoi si te bazuara nga se paditesit kete palujtshmeri e kane fituar ne baze shitblerjes dhe mbajtjes me mirbesim.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesve e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimet C. Nr. 66/2009 dt 13.03.2012 te paditureve iu caktoi Perfaqsesin e perkohshem, Avokat , nga Mitrovica i cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.

Perfaqsesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padive dhe precizimit te kerkespadive te paditesve ne fjalen perfundimtare deklaroi; se pase zhvillimit te provave i propozon gjykates qe te vendose ne baze te rezultatit te provave.

Shpenzimet e perocedures kontestmore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; ekspertzen gjeodete te ekspertit gjeodet, te dt.24.04. 2012, beri veshtrimin ne Skicat e terenit nga i njejti ekspert, ndegjoi deshmitarin; si dhe ndegjoi paditesin ne cilesi te pales dhe konstatoi kete gjendje faktike;

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te palujtshmerive nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice, ka vertetuar se palujtshmerite kontestuese bine – gjegjesishte e perbejne pjeset e parc. te cekura me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe skicen e terenit te cilat jane pjese perberse te kesaje ekspertizave dhe te aprovura si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.



Deshmitari deklaroi; qe paditesit si dhe i ati ityre tani i ndjeri Istrefi nga vajza e Kekiqit paten bler sipas marrveshjes me shkrim diku rreth 16 ari me qmim prej 14.000 Dm.,. Ne kete vende nuk ka pasur objekte te ndertuara por ka qen basqe. Blersit ne tersi e kane paguar qmimine shitblerjes dhe menjeher kan hy ne shfrytzim dhe disponite lire te kesaj palujtshmerie duke e shfrytzuar qe nga shitblerja gjer me tani.

Paditesi deklaroi; Une personalisht vllau dhe babai- Istrefi ne vit 1984 nga shitsit- vajzat kane blere diku rreth 16 ari truall-basqe me qmim te shitblerjes prej 14.000 DM, , sipase kontrates interne me shkrim, mirepo e njejta i eshte zhdukur gjate luftes ne Kosove. Qe nga shitblerja e shfrytzojn me antaret e familjes kete palujtshmeri pa pengesa gjer ne fillimin e luftes ne Kosove e qe pase luftes shfrytzimi ne kete pjes te qytetit eshte i kufizuar. Kjo basqe eshte sherbenc si oborr i shtepise sime te cilen e kame ne emrin tim, mirepo e njejta me eshte djegur gjat luftes dhe tani jame ne projektin e Qeverise per rindertimin e kesaje shtepie.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore e kane blere paditesit dhe i ati i tyre tani i ndjere nga te paditurit, sipas marrveveshjeve interne me shkrim mbi shitblerjen dhe ate ne vit 1984, me qmim te shitblerjes prej 14.000,00 DM, te cilin qmim ne tersi ia kane paguar shitesve tani te paditureve te cilet menjeher iu ka lene ne disponim dhe shfrytzim te lire kete palujtshneri- bleresve , tani paditesve te cilet se bashku me antaret e familjes se tyre e kane shfrytzuar pa pengesa kete palujtshmeri qe nga momenti i shitblerjes e gjer ne vitin 1999- luftese ne Kosove. Ndersa pase kesaje periudhe posedimi eshte i kufizuar per shkaqe te njohura ne kete pjese- Veriore te Mitrovices.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. 03/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes , paditesit e kane pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri dhe atc; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesve ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i ketyre palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesit keto palujtshmeri i kane blere nga pronaret e saje, qka vertetohet nga ekspertiza gjeodete , sipas qertifikates se pronesise nr. 1274 ZK-Mitrovice.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesit e kane blere kete palujtshmeri nga te paditeurit qysh nga vit. 1984.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesit kane hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te ketyre palujtshmerive te tyre gjer me tani.

Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesve me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejatat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450 dhe 459 te LPK.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

### **GJYKATA KMUNALE NE MITROVICE**

C.nr.66/2009.dt. 22.05.2012.

**G j y q t a r i,**  
Ragip Kadriu,

**KESHILLE JURIDIKE;** Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimet, Gjykates se Qarkut ne Mitrovice e permes kesaje gjykate.

Saktsin e pershkrimit e verteton;